



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202201129/5

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandim për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me shënimin e kohës/orës në procesverbalin e arrestimit në flagrancë të shtetasve të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale.*

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Durrës

Me shkresat nr. K2/I14-2 prot., datë 29.09.2022 dhe nr. K2/I14-3 prot., datë 03.11.2022 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi I.H.. Ankuesi shkruan se në datën 09.09.2022, ora 19:00, është arrestuar nga oficeri i policisë gjyqësore Kujtim Vreka, efektiv i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës. Sipas ankuesit, arrestimi i tij është bërë me urdhër të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Durrës, Drini Pali.

Gjithashtu ai pretendon se është shoqëruar në ambientet e këtij organi rreth orës 14:00 të datës 09.09.2022, ndërsa arrestimi i tij është bërë në orën 19:00 të kësaj date, pas 5 orësh.

Në datën 12.09.2022, rreth orës 12:00, ai ka dalë para Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe sipas tij, është tejkalluar afati 48 orë i parashikuar në nenin 28, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Përveç sa më sipër, ankuesi shkruan se ndaj tij është kryer shkelje e të drejtës kushtetuese duke i privuar lirinë në mënyrë të padrejtë sepse në ngarkim të tij nuk ka asnjë fakt që të provojë veprat penale për të cilat është arrestuar, konkretisht "Shkatërrimi i pronës" dhe "Vetëgjyqësia". Gjithashtu ai shkruan se, verbalisht në polici por edhe gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore i është thënë se arrestimi është bërë për të qetësuar gjakrat ndërmjet palëve.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” të ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në nenin 20 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”*, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, ju kërkuam që të na dërgoni një informacion lidhur me sa më poshtë vijon:

1. Cilat janë shkaqet dhe baza ligjore e arrestimit të shtetasit I.H.?
2. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimin se ankuesit se ai është arrestuar pas 5 orësh nga momenti i shoqërimit në organin e policisë?
3. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimin e ankuesit se ai është dërguar para gjykatës tej afatit prej 48 orë të parashikuar në nenin 28/2 të Kushtetutës tonë?
4. Cili është qëndrimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës lidhur me vleftësimin e arrestimit të ankuesit dhe caktimin e masës së sigurisë ndaj tij.

Bashkëlidhur me informacionin ju kërkuam të na dërgoni edhe fotokopje të fletës së regjistrimit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar në datën 09.09.2022 në Komisaratin e Policisë Durrës në të cilën janë pasqyruar gjeneralitetet e ankuesit dhe të vendimit gjyqësor të marrë ndaj tij.

Ju, me shkresën nr. 10806 prot., datë 17.11.2022, na informuat se shtetasit I.H., S.P. dhe familja e këtij të fundit ka disa kohë që janë përfshirë në një konflikt për faktin se familja Peqini ka kryer punime ndërtimi në çatinë e përbashkët në një objekt katër katësh në lagjen nr. 4, Durrës. Nga ana e Komisarimit të Policisë Durrës janë kryer veprime procedurale në lidhje me kallëzimet e bëra nga shtetasi I.H. për një ndërtim paleje që po kryen shtetasi S.P. në çatinë e përbashkët të objektit dhe në çdo rast është mbajtur praktikë nga IMT-ja e Bashkisë Durrës.

Rastet e këtyre konflikteve janë si më poshtë vijon:

Në datën 25.07.2022, në bazë të kallëzimit të bërë nga shtetasi I.H. janë referuar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale *“Ndërtimi i paligjshëm”*, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S.P.. Organi i prokurorisë ka regjistruar procedimin penal nr. 1646 të vitit 2022, i cili ndodhet në hetim nga prokurori Saimir Bahiti.

Në datën 22.08.2022, në bazë të kallëzimit të shtetasit I.H., me shkresën nr. 6605, datë 22.08.2022, janë referuar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S.P.. Organi i prokurorisë ka regjistruar kallëzimin nr. 2816 të vitit 2022, i cili është duke u hetuar nga prokurori Eglantina Shehu.

Në datën 26.08.2022, në bazë të kallëzimit të shtetasve A.P., me shkresën nr. 6741, datë 26.08.2022, janë referuar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I.H., pasi ka dëmtuar objektin që po ndërtojnë shtetasit S.P., A.P. dhe A.T.. Organi i prokurorisë ka regjistruar procedimin penal nr. 2685 të vitit 2022, i cili është duke u hetuar nga prokurori Drini Pali.

Në datën 09.09.2022, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve A.T. për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, F.N. për veprën penale “Dhënia ndihmë për ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/b i Kodit Penal dhe I.H. për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

Gjithashtu ju na informuat se shtetasi I.H. është shoqëruar në datën 09.09.2022, ora 13:30 dhe është arrestuar në flagrancë në orën 19:40, kohë kjo e domosdoshme që ka shërbyer për të kryer veprime procedurale intensive deri në dokumentimin e plotë ligjor të veprës penale.

Materialet procedurale nga ana e Komisarariatit të Policisë Durrës janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës brenda afatit 24 orësh.

Përveç sa më sipër ju na informuat se Gjykata e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 563, datë 12.09.2022 ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit I.H. për veprën penale “Shkatërrimi i pronës” dhe ka caktuar masën e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”.

Së bashku me informacionin ju na dërguat edhe fotokopje të shkresës përcjellëse të Komisarariatit të Policisë Durrës nr. 7145 prot., datë 11.09.2022 për dërgimin e materialeve procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në ngarkim të shtetasve A.T., F.N. dhe I.H.; të fletës së regjistrimit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar në datën 09.09.2022 në Komisarariatin e Policisë Durrës, në të cilën janë pasqyruar të dhënat e shtetasit I.H.; dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 563, datë 12.09.2022 me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasve I.H., A.T. dhe F.N. dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tyre.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, të përgjigjes së dërguar nga ana juaj dhe e dokumentacionit bashkëlidhur asaj, konstatojmë se:

1. Referuar përgjigjes tuaj dhe fletës së regjistrit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar në datën 09.09.2022 në Komisaratin e Policisë Durrës, në të cilën janë pasqyruar të dhënat e shtetasit I.H., rezulton se shoqërimi i tij në këtë komisarariat është bërë në bazë të nenit 109/1/c të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Në këtë dispozitë ligjore parashikohet e drejta e punonjësit të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e personave në ambientet e policisë ose institucionin urdhërdhënës edhe në kushtet dhe rastet kur ka dyshime të arsyeshme se kanë kryer veprë penale. Sikurse u përshkrua më sipër, shtetasi I.H. është shoqëruar në orën 13:30 të datës, 09.09.2022 sepse ndaj tij ka pasur dyshime se ka kryer veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Pra, ndodhur në këto rrethana ne vlerësojmë se shoqërimi i këtij shtetasi në mjediset e policisë është i bazuar në ligj.

2. Në nenin 112/2/e të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar se, në rastet e arrestimit/ndalimit policia evidenton për çdo person të dhënat për orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit. Nga përgjigjja juaj dhe vendimi gjyqësor i cituar më sipër rezulton se shtetasi I.H. është arrestuar në flagrancë për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Arrestimi i tij në flagrancë është vleftësuar i ligjshëm nga gjykata.

Për sa më sipër, çmojmë se, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti, ora, e kapjes së tij në fakt, kur atij i është privuar realisht liria. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë, apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrit të ndalimit nëse do të ndodhemi në rastet e ndalimit në bazë të urdhrave të organit të prokurorisë.

Duke iu referuar neneve 144 e 250 të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P.), shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258, pika 1, të K.Pr.P., nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Theksojmë se, nga procesverbali i arrestimit në flagrancë të shtetasit I.H, të cilin na e ka sjellë ankuesi, rezulton se arrestimi i tij është bërë në orën 19:00 të datës 09.09.2022. Ndërsa nga fleta e regjistrit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar në datën 09.09.2022 në Komisaratin e Policisë Durrës, rezulton se shoqërimi i shtetasit I.H. është bërë në orën 13:30 të datës 09.09.2022, ndërsa arrestimi i tij është bërë në orën 19:40 të po kësaj date. Pra, ora e arrestimit të tij e pasqyruar në procesverbalin e arrestimit në flagrancë, i cili është një nga dokumentet që administrohet në fashikullin penal, nuk është e saktë, sepse është vendosur ora e mbajtjes/përpilimit të procesverbalit dhe jo ora faktike e arrestimit të tij në flagrancë. Diferenca kohore ndërmjet orës faktike dhe asaj të pasqyruar/vendosur në procesverbalin e arrestimit në flagrancë është 5 orë e 30 minuta.

Arsyetimi i bërë në përgjigjen e dërguar nga ana juaj se, *periudha kohore nga çasti i shoqërimin të shtetasit I.H., në orën 13:30 dhe deri në orën e arrestimit në flagrancë të tij,*

në orën 19:40, ka qenë domosdoshme dhe ka shërbyer për të kryer veprime procedurale intensive për dokumentimin e plotë ligjor të veprës penale, nuk është i bazuar në ligj.

Konstatohet se nuk është kuptuar e zbatuar drejt përmbajtja e nenit 252 të K.Pr.P. ku parashikohet se: *“Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale”.*

Nga sa parashtruar më sipër, rezulton se shtetasi I.H. është kapur nga punonjësit e policisë në vendin e ngjarjes, në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së veprës penale të “Shkatërrimit të pronës”. Fakti që ai është regjistruar në regjistër në orën 13:30 provon se momenti, çasti real, i saktë dhe i vërtetë i arrestimit të tij në flagrancë është para se ai të sillej në organin e policisë e regjistrohej. Pra, të paktën ora 13:30, e cila është më afër çastit të arrestimit të tij në flagrancë, duhet të ishte koha e shënuar në procesverbalin e arrestimit në flagrancë dhe jo koha kur është përpiluar ky procesverbal nga oficeri i policisë gjyqësore.

Sqarojmë se ne nuk jemi kundër faktit të përpilimit nga oficerët e policisë gjyqësore të dokumentacionit përkatës ligjor pas momentit të arrestimit në flagrancë të një personi, duke përfshirë edhe procesverbalin e arrestimit, të marrjes së deklarimeve, etj., por, për të ndryshuar praktikën e padrejtë lidhur me këtë çështje, duke bërë shënimin/pasqyrimin e saktë të kohës/çastit të arrestimit në flagrancë të shtetasve. Ndërsa procesi i dokumentimit të plotë të veprës penale dhe të fajësisë së autorit të dyshuar është i gjatë dhe nuk përfundon me arrestimin apo ndalimin e një personi. Sjellim në vëmendje se në nenin 294 të K.Pr.P. “Sigurimi i burimeve të provave” parashikohet se:

“1. Edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Ajo procedon sidomos:

- a) për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme;*
- b) për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit;*
- c) për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese.*

2. Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës.

3. Kur kryen veprime që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, me iniciativën e saj ose të deleguara nga prokurori, policia gjyqësore mund të caktojë ekspertë, të cilët nuk mund të refuzojnë detyrën e ngarkuar, pa shkaqe të ligjshme”.

Theksojmë se lidhur me këtë problematikë, në rekomandimet e bëra në vijimësi që prej më shumë se dhjetë vjetësh nga Avokati i Popullit, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit është kërkuar që, edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi,

në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet të vihet/shënohet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij. Është e nevojshme që të sqarojmë se këto rekomandime janë vlerësuar të drejta dhe janë pranuar nga Policia e Shtetit. ***Për këtë fakt i referohemi edhe përgjigjeve të dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit respektivisht me shkresat nr. 12/1 prot., datë 13.02.2018 dhe nr. 267/1 prot., datë 07.03.2018.***

3. Përveç sa më sipër konstatojmë se informacioni i dërguar nga ana juaj se, *materialet procedurale nga ana e Komisarariatit të Policisë Durrës janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës brenda afatit 24 orësh*, nuk është i saktë. Ky konstatim provohet më së miri nga fotokopja të shkresës përcjellëse të Komisarariatit të Policisë Durrës nr. 7145 prot., datë 11.09.2022 për dërgimin e materialeve procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në ngarkim të shtetasve A.T., F.N. dhe I.H.. Sqarojmë se data e arrestimit të ankuesit dhe e dy shtetasve të tjerë është 09.09.2022, ndërsa data referimit në organin e prokurorisë të dokumentacionit procedural të përpiluar nga oficerët e policisë gjyqësore për këtë rast është 11.09.2022, pra, pas dy ditësh nga arrestimi i tyre dhe jo brenda 24 orëve.

Sjellim në vëmendje se referuar neni 255, pika 1, të K.Pr.P. “Detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit”, *Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi*. Respektimi i këtij detyrimi ligjor për njoftimin e menjëhershëm të prokurorit është me rëndësi sepse lidhet ngushtësisht me detyrimin e prokurorit të parashikuar në nenin 258, pika 1, të K.Pr.P. “Kërkesa e vleftësimit të arrestimit ose ndalimit”, ku parashikohet se: “*Kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, prokurori, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë....*”.

Sqarojmë se në këtë rast nuk kemi konstatuar se vonesa e dërgimit të dokumentacionit nga Komisariami i Policisë Durrës në organin e prokurorisë ka sjellë si pasojë dërgimin në gjykatë tej afatit 48 orësh të kërkesës së prokurorit për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit personal për shtetasit I.H., etj. Pavarësisht këtij fakti, raste të tilla nuk duhet të përsëriten në të ardhmen sepse passjellin pasoja juridike lidhur me humbjen e fuqisë së arrestimit ose ndalimit të një shtetasi¹.

Avokati i Popullit në përmbyshje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ***si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend***, gjykon se bazuar në evidentimin e

¹i cili mund të ketë rrezikshmëri të lartë shoqërore

problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga ana juaj për të garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të arrestuar në ambientet e komisariateve të policisë në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDIMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësiive konkrete ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet ligjore të parashtruara më sipër.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin e praktikës së deritanishme të oficerëve të policisë gjyqësore lidhur me shënimin/pasqyrimin e orës së arrestimit në flagrancë të shtetasve të shoqëruar si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për dërgimin e materialeve procedurale në organin e prokurorisë në mënyrë të menjëhershme në të gjitha rastet e arrestimeve në flagrancë ose ndalimeve të shtetasve nga oficerët e policisë gjyqësore.
4. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat në varësi të organit tuaj me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi